



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:003181  
Datë: 27.02.2024  
Numri i dokumentit: 05397006

P.nr.71/24

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Eroll Gashi, me zyrtaren ligjore Merita Mazreku, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. S., nga T., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr..../24, të dt.24.01.2024, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur më dt.23.02.2024, në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorit të shtetit Kushtrim Zeka, të dëmtuarve I., E., D. dhe R. G., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.-Shpëtim Mehmeti, nga Prishtina, me autorizim, më dt.26.02.2027, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më dt.27 Shkurt 2024, me shkrim e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**M. S.**, nga i ati H. dhe e ëma B. e gjinisë Sh. , i lindur me (data e lindjes) në Fati-S.-T.tani me vendbanim në Rr. "I. D.", lllamella .. nr. ..- Prishtinë, me numër personal: ....., ka të kryer shkollën e mesme, punon në Firmë të Ndërtimitarisë "A.-G.", i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, T., Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mire se më datë 01.01.2024 rreth orës 15:20 min, në rrugën nacionale P.-M., saktësisht në fshatin Ll., K. P., i pandehuri M. S., me Dashje eventuale (dolis eventualis), ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 , nenin 231 par.1 dhe nenin 250 par.2 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe me këtë ka shkaktuar aksident trafiku

me lëndime të renda trupore dhe këtë rrezikon jetën e njerëzve si pjesëmarrës në komunikacion, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka drejtuar automjetin e tipit "A. A.", ngjyra e kaltër, me targa O.-...-..., pa patën shofer (të cilit i është marrë patentë e shoferit përkatësisht i është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik sipas ligjit në fuqi), dhe duke lëvizur me shpejtësi rreth 60 km/h, në zonën e kufizuar 40 km/h, dhe duke mos e mbajtur shiritin e vetë qarkullues, hyn në tejkallim të automjete në vije të ndërprerë dhe gjate kthimit në shiritin e tij qarkullues, humb kontrollin ndaj automjetit të tij dhe kalon në shiritin e kahjes së kundërt dhe me pjesën e parë ballore e godet automjetin e tipit "VW- G.", i cili ishte në shiritin e vetë lëvizës, dhe si rezultat i kësaj shkaktohet aksident trafiku me dëme të mëdha materiale ndërsa lëndime të renda trupore pësojnë shoferi dhe pasagjeret e automjetit "VW- G.", përkatësisht të dëmtuarit I. G., E. G., D. G., dhe R. G., ndërsa lëndime të lehta trupore pësoj të dëmtuarit A. G. dhe E. G., lëndime këto të konstatuar më hollësisht në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr.Flamur Blakaj, i datës 12.01.2024,-

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.1 të KRPK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 2, 4, 7, 17, 23, 38, 39, 40, 42, 44, 59, 64, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KRPK-së, si dhe neneve 242, 364, 449 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIMI ME BURGIM**

Ashtu që për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.1 të KRPK-së:

- Të akuzuarit M. S., i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Pas shpalljes së aktgjykimit, konform nenit 44 të KRPK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë), muajve, zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) euro, të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në dy këste mujore, më së largu deri më datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
- Në dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej dt.01.01.2024, e deri më dt.23.02.2024, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në masës së arrestit shtëpiak do të barazohet me 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë.

- Nëse dënimi i mbetur në të holla nuk mund të ekzekutohet, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.
- Gjykata në mbështetje të nenit 59 par.2 nënpar.2.5 lidhur me nenin 64 par.1 të KPPRK-së, ndaj të akuzuarit i shqipton dënimin plotësues:
  - Ndalimi i drejtimit të automjetit, për kategoritë B1 dhe B2, në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
  - Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve, për ekspertizën mjekoligjore shumen prej 50 euro, për ekspertizën e komunikacionit rrugorë shumën prej 150.00 euro, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

### **1. Ecuria e procedurës penale:**

1.1 Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, më dt.24.01.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.../24, ndaj të akuzuarit M. S., për shkak të veprës penale penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

**1.1.1 Kompetenca territoriale** - Gjyqtari ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në P., konkretisht në fshatin Ll., K. P., që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

**1.1.2 Kompetenca lëndore** - Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku për atë vepër penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në dhjetë vite, dhe po ashtu kjo vepër penale nuk është përfshirë në nenin 22 të KPPRK-së. Në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, e dënueshme me burgim prej një (1) vit deri në tetë (8) vjet dhe e njëjta bije në kompetencë lëndore në këtë departament.

1.2 Me dt.23.02.2024, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar lidhur me këtë çështje juridike, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurori i shtetit Kushtrim Zeka, të dëmtuarit I., E., D. dhe R. G., i akuzuari M. S. si dhe mbrojtësi i tij av.-Shpëtim Mehmeti, ku edhe ka njoftuar të pandehurin për të drejtat e tij konform nenit 241 par.1 të KPP-së.

1.3 Pas leximit të akuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari lidhur me fajësinë deklaroi se: E ndjej veten fajtor për veprën penale, ndihem shumë keq për këtë që ka ndodhur të dëmtuarve ju kërkoi falje sot publikisht që kam bërë dëm dhe shqetësim, nuk e kam bërë asgjë me qëllim të keq dhe kërkoi falje 100 herë, unë asnjëherë më parë nuk kam rënë ndesh me ligjin, premtoi Gjykatës se më asnjëherë nuk do të përsëris vepër tjetër penale , dua ta falënderoi familjen G., për te gjitha sjelljet e mira që kanë bërë ndaj neve, kemi qenë të interesuar dhe familja ime ka kontaktuar me familjen e të dëmtuarve , ne jemi përkujdesur edhe për nevojat e tyre dhe premtoi që çfarëdo që të këtë familja G., në të ardhmen unë dhe familja ime do te mundohemi të jemi pranë tyre, i kërkoi edhe njëherë falje edhe Gjykatës e gjithashtu edhe prokurorit dhe i propozoi Gjykatës që mundësisht të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

1.4 Mbrojtësi i të akuzuarit av.-Shpëtim Mehmeti, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se: I mbrojturi im pas konsultës paraprake me mua ne cilësinë e avokatit mbrojtës e pranon fajësinë ashtu siç e ngarkon akuza duke pasur parasysh pasojat dhe benefitet lidhur me këtë veprim procedural , po ashtu e njoftoi Gjykatën se i mbrojturi im që nga fillimi do te thotë para ngritjes se aktakuzës e po ashtu edhe ne prokurori e ka pranuar fajësinë ka shprehur keqardhje për këtë që ka ndodhur me një sinqeritet te plote ka deklaruar se nuk ka pas për qëllim të shkaktoj dëm askujt e aq me pak fëmijëve, ne këtë aksident edhe vete i pandehuri ka pasur lëndim te rende trupor po ashtu e njoftoi gjykatës se i mbrojturi im asnjëherë me pare nuk ka rende ndesh me ligjin dhe është hera e pare dhe besoi se e fundit që i njëjti ballafaqohet me një akuzë. Andaj i propozoi Gjykatës që si rrethane posaçërisht lehtësuese të merr pranimin vullnetar te fajësisë , keqardhjen e madhe ne raport me familjen e dëmtuar e te cilët janë pajtuar ne mes vete ashtu siç parashihet me zakonet tona , pa asnjë kusht dhe për këtë jemi shumë falënderues familjes po ashtu i njëjti ndjen keqardhje madhe edhe ne raport me Gjykatën dhe Prokurorinë, premtonte se ne te ardhmen do te jete shume i kujdesshem ne veprimet e tija, i njëjti është i moshës se re është rritur pa baba është i vetmi person që kujdes për nënën e tij dhe ka pasur te domosdoshme që ta ngas automjetin për shkak që i njëjti ka pasur te blejë disa medikamente atë ditë për furnizim ne familjen e tij, konsideroi se ne raport me te mbrojturin tim M. S., janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 71 par 1 pika 1.3 të KPRK-së, që pranimin e fajësisë Gjykata ta trajtojte posaçërisht si rrethanë lehtësuese që e favorizojnë procedurën e dënimit andaj lusim

Gjykatën që të mbrojturin tim ti shqiptoi një dënim komfor nenit 48 dhe 49 të KPRK-së, me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti të cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 viteve nuk do të kryej ndonjë veprë tjetër penale, apo Gjykata të mbrojturit tim të shqiptoi një dënim me burgim një kohëzgjatje prej 6 muaj të cilin dënim Gjykata me pëlqimin e palës të zëvendësojë me dënim me gjobe aq sa do ta vlerësojë vetë Gjykata dhe konsiderojmë se me këtë që u tha me sipër do të arrihet edhe qëllimi i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

1.5 Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi i njëjti gjen mbështetje në provat personale dhe materiale që gjenden në aktakuzë të pandehurit ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij andaj i propozojmë Gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe të pandehur ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ku me rastin e llojit të përcaktimit të lartësisë të dënimit i propozojmë Gjykatës që të marrë parasysh si rrethanë rënduese nga neni 70 par 2 pika 2.1 shkallën e lartë të pjesëmarrjes nga i pandehuri pika 2.5 vepra penale përfshirë disa viktime pika 2.6 vepra penale përfshirë viktime të ndejshme, pika 2.7 moshën e viktimave ndërsa si rrethanë lehtësuese nga neni 70 par 3 pik 3.10 pranimin e fajit dhe pika 3.11 keqardhjen që ka shprehur i akuzuari..

1.6 I dëmtuari I. G. deklaroi: Na nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, ndërsa parashtrojmë kërkesë pasurore juridike.

1.7 Adelina Gashi përfaqësuese ligjore e të dëmtuarave E., D. dhe R. G., prezantoi në sallë, e njëjta deklaroi se unë nuk dua që askush të dënohet për këtë qysh ditën e parë që ka ndodhur në ja kemi falur por si nënë jam e lënduar shumë dhe kërkesa ime është ajo vetëm sa i përket dëmeve që kemi pësuar.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë:

2.1 Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari M. S., ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par.1 të KPPK-së. Në këtë aspekt, gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë si dhe pas konsultimit të mjaftueshëm edhe me mbrojtësin e tij, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pa imponim, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e

çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar:

3.1 Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetme gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i akuzuari M. S., ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, në datën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës.

### 4. Elementet e veprës penale:

4.1 Në par.1 të nenit 378 të KPRK-së, është përcaktuar se, forma themelore e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, sipas së cilës dispozitë, është paraparë se këtë vepër penale e kryen: *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim trupore ose dëm pasuror”*, ndërsa sipas par.4 të të njëjtit nenë, është paraparë forma e kualifikuar e veprës penale, sipas së cilës dispozitë, parashihet: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”*.

4.2 Prandaj, nga dispozitat e lartcekura rezulton se, në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe se në veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë i akuzuari në shqyrtimin fillestarë, i cili me Dashje eventuale (dolos eventualis), ka vepruar në kundërshtim me nenin 41, nenin 231 par.1 dhe nenin 250 par.2 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe me këtë ka shkaktuar aksident trafiku me lëndime të rënda trupore dhe këtë rrezikon jetën e njerëzve si pjesëmarrës në komunikacion, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri ka drejtuar automjetin e tipit “A. A.”, ngjyra e kaltër, me targa O-...-..., pa patën shofer (të cilit i është marrë patentë e shoferit përkatësisht i është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik sipas ligjit në fuqi), dhe duke lëvizur me shpejtësi rreth 60 km/h, në zonën e kufizuar 40 km/h, dhe duke mos e mbajtur shiritin e vetë qarkullues, hyn në tejkallim të automjete në vije të ndërprerë dhe gjate kthimit në shiritin e tij qarkullues, humb kontrollin ndaj automjetit të tij dhe kalon në shiritin e kahjes se kundërt dhe me pjesën e parë ballore e godet

automjetin e tipit "VW- G.", i cili ishte në shiritin e vete lëvizës, dhe si rezultat i kësaj shkaktohet aksident trafiku me dëme të mëdha materiale ndërsa lëndime të rënda trupore pësojnë shoferi dhe pasagjeret e automjetet "VW- G.", përkatësisht të dëmtuarit I. G, E. G., D. G., dhe R. G., ndërsa lëndime të lehta trupore pësoj të dëmtuarit A. G. dhe E. G., lëndime këto të konstatuar më hollësisht në akt ekspertimin mjeko ligjor.....

#### 5. Vendimi për shpalljen fajtor:

5.1 Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin M. S., t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur meqenëse u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

6.1\_Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit M. S., Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lartë, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestarë, e që kjo është një rrethanë e cila duke i ndërlidhur me rrethanat tjera, si fakti se i njëjti është penduar për kryerjen e veprës penale, i ka kërkuar falje gjykatës edhe palës së dëmtuar, faktin se është hera e parë që ka kryer vepër penale, tashmë është punësuar dhe ka krijuar familje, si dhe premtimi i tij ndaj gjykatës dhe prokurorisë që asnjëherë nuk do të kryej vepër penale, janë rrethana që e arsyetojnë zbutjen e dënimit, sipas neneve 71 dhe 72 të KPRK-së, e të cilat tregojnë se edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe se i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale.

6.2 Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese ka gjetur: faktin se nga ky aksident kanë pësuar lëndime të rënda kanë pësuar katër presona, dhe vetë i akuzuari, ku prej tyre tre janë fëmijë, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe do të ndikojë në riedukimin dhe risocializimin e tij.

#### 7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar:

7.1 Sipas bindjes së Gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, është zëvendësuar me dënimin me gjobë në shumën prej 3000.00 (njëmijë Euro), duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

7.2 Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, (duke e bërë të vetëdijshëm për natyrën dhe shkallën e dënimeve për veprat penale që mund të kryej në të ardhmen, por edhe për mundësin që të kthehet në një element kontribuues për vete, familjen dhe për rrethin ku ai jeton) të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Vendimi me të cilin të akuzuari i është shqiptuar Dënim plotësues:

8.1 Gjykata në mbështetje të nenit 59 par.2 nënpar.2.5 lidhur me nenin 64 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit i shqipton dënimin plotësues:- Ndalimi i drejtimit të automjetit, për kategoritë B1 dhe B2, në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### 9. Vendimi me të cilin të akuzuarit i llogaritja koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak:

9.1 Duke u bazuar në nenin 79 të KPRK, në dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej dt.01.01.2024, e deri më dt.23.02.2024, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në masës së arrestit shtëpiak do të barazohet me 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë.

#### 10. Zëvendësimi i dënimit me gjobë:

10.1 Duke u bazuar në nenin 43 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që nëse i akuzuarit refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë gjykata dënimin me gjobë, do tja zëvendësoj në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

#### 11. Udhëzimi i të dëmtuarve në kontest juridiko - civil:



11.1 Gjykata konform nenit 462 të KPPRK-se, vendosi që të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt civil..

**12. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:**

12.1 Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar nënin 450 par.1 të KPP-së, është detyruar i akuzuari konform dispozitave ligjore të nenit 449 të KPP-së, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve për ekspertizën mjekoligjore shumen prej 50 euro, për ekspertizën e komunikacionit rrugorë shumën prej 150.00 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

10.2 Vendimin për Kompensimin e Viktimave të Krimit u morë në bazë të Ligjit nr.05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.71/24, më dt.27 Shkurt 2024.**

**Zyrtare Ligjore  
Merita Mazreku**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Eroll Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.